

Emri i Lëndës : Metodat e Kërkimit Shkencor							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
CMP 403	C	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Elda Dollija, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Lënda Metodat e Kërkimit Shkencor ndihmojnë në përgatitjen e një punimi të mirë, që njëherazi mund të vlejë për të rifituar besimin në dobinë dhe vlerën përparim sjellëse të të studiuarit, të kuptuar jo thjesht si grumbullim të dhënash, por si përpunim kritik i një përvoje, dhe si një fitim aftësie. Ky kurs ligjëratash ka për qëllim të shpjegojë se si mund të kryhet një studim që mbështetet në metodën e duhur, duke dhënë kështu ndihmesë teoriko-kritike-analitike rreth dobisë së të marrit me studime, por dhe do të udhëzojë e ndihmojë lidhur me mënyrën se si mund të punohet një punim konkret. Thënë më shkurt, programi përmban sasi të mjaftueshme të materialeve teorike, për t'i dhënë rëndësi të veçantë punës praktike, nga e cila krijohet një bazament i qëndrueshëm për të ndërtuar intelektualisht.					
Objektivat		Të marrë njohuri bazë mbi metodat e avancuara shkencore të kërkimit Të përvetësohen konceptet operative për të nxitur përvetësimin e njohurive që kanë të bëjnë me hartimin me shkathtësi, si një përgatitje modern, pa të cilën është vështirë të rreshtohen studentët në rrafshin e të kuptuarit, të interpretimit, të pavarësimit si dhe të daljes nga rrethi vicioz i kohës. Të arrijnë studentët që duke aplikuar instrumentët metodologjikë, të mundësojnë shqyrtimet teorike duke kaluar në veprime konkrete, në hulumtime, observime dhe hartime të punëve profesionale, si një hap për të hyrë në brendinë e shkencës. Kursi i ligjëratave Master mundëson veprim origjinal, të pavarur, komunikim me vlerat e shkuara, si dhe të skicimit të ideve me performancë të dobishme për zhvillimin e tërësishëm të kulturës,si parakusht i gjithë zhvillimeve të tjera.					
Konceptet Kryesore		1. Metodat e Hulumtimit 2. Rishikim Literature 3. Metodologjia 4. Përpunimi dhe Analiza e të dhënave 5. Plagjiatura					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Ç'është kërkimi shkencor? Karakteristikat e kërkimit shkencor. Cilësia në kërkime shkencore. Prezantim i përgjithshëm i kërkimit shkencor, rëndësia e tij si pjesë integrale e përgatitjes së punimeve shkencore, punimi i diplomës dhe analiza e të dhënave. Shembuj të punimeve të një cilësie të lartë kërkimore për të ilustruar me shembuj konkret cilësinë në kërkimin shkencor. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 6-15						
2	Dijet, teoritë paradigmë dhe këndvështrimet. Natyra e subjektit të kërkimit shkencor në shkencat sociale. Përshkrim historik i zhvillimit shkencor dhe shpjegimi i koncepteve bazë të termave kryesore që do të hasen gjatë zhvillimit të lëndës, teoritë kryesore dhe evolimi i tyre ndër vite. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 16-41						
3	Natyra e të dhënave. Karakteristikat e të dhënave. Përdorimi i të dhënave si përfaqësim i realitetit shoqëror. Shpjegim i natyrës së të dhënave dhe shpjegim i tre koncepteve bazë, të dhëna cilësore, sasiore dhe mikse. Shembuj konkret i përdorimit të tyre në punime specifike. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 42-55						
4	Pyetjet e kërkimit shkencor, hipotezat, përkufizimet operative të kërkimit shkencor. Në këtë leksion do të shpjegohet procesi i përzgjedhjes së një teme kërkimore, llojet e variablaeve, llojet e hipotezave si dhe vizualizimi i një pyetje kërkimore. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq.56-69						

5	Planifikimi i një projekti kërkimi shkencor. Përkufizimi, aspekte praktike. Studentët do të përpqen të realizojnë pjesën e parë të një projekt propozimi bazuar nga shpjegimi i leksioneve të deritanishme. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 88-91
6	Vlerësimi kritik i literaturës. Kërkimi i literaturës. Aspekte praktike të shqyrtimit të literaturës. Procesi i shqyrtimit të literaturës. Rëndësia e rishikimit të literaturës si pjesë bazë e punimit shkencor. Përse është i rëndësishëm rishikimi i literatures dhe si ndihmon kërkuesin për t'u përfshirë më së miri në kërkimin shkencor dhe për të formuar një bazë të punimit të tij. Formate të rishikimit të literaturës. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 92-108
7	Modelet e kërkimit të avancuar. Modeli cilësor dhe modeli sasior. Niveli dhe njësia e kërkimit shkencor. Strategjitë e kërkimit shkencor. Do të shpjegohen llojet dhe modelet e hulumtimit duke u bazuar në punime konkrete të secilit lloj. Si duhet të përgatitemi për secilin nga formatet e hulumtimit dhe cilat janë karakteristikat e secilit nga modelet. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 110-139
8	Projekt
9	Mbledhja e të dhënave. Pyetësorët, intervistat gjysëm të strukturuar. Si realizohet procesi i mbledhjes së të dhënave, si duhet të formulohen pyetjet dhe si realizohet përgatitja paraprake përpara procesin të intervistimit. Transkriptimi dhe zbardhja e intervistave. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 180-189
10	Grupet e fokusit. Vrojtimi. Burimet dytësore të të dhënave. Shpjegim i detajuar i burimeve dytësore dhe integritet të tyre së bashku me të dhënat primare gjatë procesit të kërkimit shkencor. Roli i tyre në këtë proces dhe justifikimi i përdorimit të tyre gjatë përshkrimit të metodologjisë. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 234-251
11	Analiza e të dhënave. Tiparet e analizës. Analiza statistikore. Llojet e analizës së të dhënave dhe shembuj konkret të realizuar nga punime të ndryshme akademike. Shpjegim i analizës statistikore dhe rëndësisë së saj si pjesë e punimit dhe gjetjes së rezultateve. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 342-371
12	Analiza tematike. Puna me të dhëna cilësore. Analiza e rrëfimeve. Analiza e ligjërimit. Analiza e përmbajtjes. Karakteristikat e të dhënave cilësore dhe ndryshimi i tyre nga të shënat sasiore. Elementet bazë që duhet të merren parasysh për realizimin e këtij procesi dhe të vecantat krahasuar me të dhënat sasiore. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 372-385
13	Përdorimi i kompjuterit në shkrimin akademik Cfarë mund të bëjë me anë të kompjuterit? Analiza statistikore. Përdorimi i programit SPSS "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 406-426
14	Hartimi i variantit përfundimtar të punimit Shpjegim teorik i përfundimit të diplomës ose shkrimit akademik dhe mbyllja e procesit në fund. Dorëzimi i projekt propozimit të realizuar sipas fazave përgjatë zhvillimit të lëndës. "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010, fq. 434-453
15	Perseritje dhe dorëzimi i Projektit final
16	Final Exam
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • "Metodat e Hulumtimit", Mathews & Ross, 2010,	
Referenca të tjera	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studenti do të jetë në gjendje të shpjegojë teoritikisht elementet bazë të metodave të hulumtimit.
2	Të dallojë metodat e kërkimit shkencor dhe t'i identifikojë në punime të caktuara.
3	Te shkruajë një punim shkencor duke përfshirë të gjithë elementet integral të tij.
4	Të jetë i aftë të vendosë referencat sipas formatit të kërkuar

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	30	30
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00